

LIGJ
Nr. 71/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM PËR PROJEKTIN “MIRËMBAJTJE DHE SIGURI RRUGORE BAZUAR NË
REZULTATE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndër-kombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9174, datë 14.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Departamenti ligjor
Draft konfidencial
Teksti përfundimtar i negociuar
(Objekt ndryshimi)
V. Bansal/N. Rukuba-Ngaiza
29 janar 2014
HUAJA numër _____-AL

MARRËVESHJE HUAJE
(PROJEKT I MIRËMBAJTJES DHE
I SIGURISË RRUGORE I BAZUAR
NË REZULTATE)

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Datë _____, 2015
HUA NUMËR _____-AL

Marrëveshje e datës _____2015, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka). Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushte të përgjithshme; përkufizime

1.01 Kushtet e Përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Me përjashtim të rasteve kur kërkohet ndryshe nga konteksti, termat që fillojnë me shkronja të mëdha, të përdorur në këtë Marrëveshje, kanë kuptimet që u jepen në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2 Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej gjashtëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind mijë eurosh (€ 65,900,000), ku kjo shumë mund të konvertohet herë pas here nëpërmjet kursit të këmbimit valutor në pajtim me dispozitat e seksionit 2.08 të kësaj Marrëveshjeje (Huaja) për të asistuar në financimin e Projektit të përshkruar në pjesën 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë fondet e Huas në përputhje me seksionin IV, të pjesës 2, të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Komisioni i administrimit i pagueshëm nga Huamarrësi është i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) të shumës së Huas.

2.04 Komisioni i angazhimit i pagueshëm nga Huamarrësi është i barabartë me një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit të shumës së Huas gjendje që nuk është tërhequr.

2.05 Interesi i pagueshëm nga Huamarrësi për çdo periudhë interesi është me një normë të barabartë me normën e referencës për monedhën e huas plus marzhin fiks; me kusht që për një këmbim të të gjithë ose të një pjese të shumës së principalit të Huas, interesi i pagueshëm nga Huamarrësi gjatë periudhës së këmbimit për këtë shumë, të përcaktohet në pajtim me dispozitat përkatëse të nenit IV të Kushteve të Përgjithshme. Pavarësisht sa më sipër, nëse një shumë e Balancës së Tërhequr të Huas mbetet e papaguar kur bëhet e kërkueshme dhe ky mospagim vazhdon për një periudhë prej tridhjetë ditësh, atëherë interesi i pagueshëm nga Huamarrësi llogaritet sipas parashikimit në seksionin 3.02/e të Kushteve të Përgjithshme.

2.06 Datat e pagesave janë 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

2.07 Shuma e principalit të Huas shlyhet në pajtim me afatin e amortizimit të parashikuar në pjesën 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.08 a) Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë një prej Konvertimeve të mëposhtme të termave të Huas, me qëllim që të lehtësohet menaxhimi i arsyeshëm i borxhit: i) ndryshimin e monedhës së Huas për të gjithë ose për një pjesë të shumës së principalit të Huas, të tërhequr ose të patërhequr, në një monedhë të aprovuar; ii) ndryshimin e bazës së normës së interesit të zbatueshme për: A) të gjithë ose një pjesë të shumës së principalit të Huas të tërhequr dhe të pakthyer nga një Normë e Ndryshueshme të një Normë Fikse ose anasjellas; ose B) të gjithë ose një pjesë të shumës së principalit të Huas të tërhequr dhe të pakthyer nga një Normë e Ndryshueshme e bazuar në një Normë Reference dhe Marzhi i Ndryshueshëm të një Normë e Ndryshueshme bazuar në një Normë Reference Fikse dhe Marzhin e Ndryshueshëm ose anasjellas; ose C) të gjithë shumën e principalit të Huas të tërhequr dhe të pakthyer nga një Normë e Ndryshueshme bazuar në një Marzh të Ndryshueshëm të një Normë e Ndryshueshme bazuar në një Marzh Fiks; dhe iii) caktimin e kufijve për Normën e Ndryshueshme ose Normën e Referencës të zbatueshme për të gjithë ose për një pjesë të shumës së principalit të Huas të tërhequr dhe të pakthyer nga vendosja e një Tavanit të Normës së Interesit ose e Normës së Interesit brenda një Intervali të Caktuar me një Normë të Ndryshueshme ose Normë Reference.

b) Çdo këmbim i kërkuar sipas paragrafit “a” të këtij seksioni, që pranohet nga Banka konsiderohet “Këmbim”, sipas përkufizimit në Kushtet e Përgjithshme dhe realizohet në pajtim me dispozitat e nenit IV të Kushteve të Përgjithshme dhe të udhëzimeve për këmbimin.

c) Menjëherë pas Datës së Ekzekutimit për një Tavan të Normës së Interesit ose një Normë Interesi brenda një Intervali të Caktuar për të cilin Huamarrësi ka kërkuar që primi të paguhet nga fondet e Huas, Banka, në emër të Huamarrësit do të tërheqë nga Llogaria e Huas dhe do t'i paguajë vetes shumën që duhet për të paguar çdo prim të pagueshëm në përputhje me seksionin 4.05/c të Kushteve të Përgjithshme deri në shumën e caktuar herë pas here për qëllimin në tabelën në seksionin IV, të pjesës 2, të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3 Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij për objektivat e Projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi zbaton Projektin nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar në përputhje me dispozitat e nenit V të Kushteve të Përgjithshme.

3.02 Pa cenuar dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe përveçse kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi garanton zbatimin e Projektit në përputhje me dispozitat e pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Hyrja në fuqi; zgjidhja

4.01 Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi përbëhen nga sa vijon: Huamarrësi nëpërmjet MTI-së ka përgatitur dhe miratuar një Manual të Funkcionimit të Projektit në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

4.02 Afati i hyrjes në fuqi është 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Përfaqësimi, adresat

5.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave i Huamarrësit.

5.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3

Tiranë, Shqipëri

Faks:

+355 42228494

5.03 Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Adresa kabllore:

INTBAFRAD

Washington, D.C.

Teleks:

248423 (MCI) ose

64145(MCI)

Faks:

1-202-477-6391

Rënë dakord në _____, _____ në ditën dhe vitin e shënuar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga:

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RIN-DËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga:

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

PJESA 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

Objektivat e Projektit janë: a) të ruajë kushtet dhe të përmirësojë sigurinë e rrjeteve rrugore parësore dhe dytësore të Huamarrësit; dhe b) të fuqizojë praktikën e qëndrueshme dhe efikase të menaxhimit të aseteve rrugore e të sigurisë në përfitim të përdoruesve të rrugës.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Punime mirëmbajtjeje dhe monitorimi

a) Realizimi i mirëmbajtjes periodike dhe rutinë të rrugëve parësore dhe rrugëve parësore-dytësore.

b) Kryerja e veprimtarive për të monitoruar mirëmbajtjen e rrugëve parësore dhe të rrugëve parësore-dytësore dhe sigurimi se nivelet e përcaktuara të shërbimit respektohen, duke përfshirë: i) kryerjen e auditimeve fillestare për mirëmbajtjen e rrugëve; ii) realizimin e studimeve investiguese periodike të Programit Ndërkombëtar për Vlerësimin e Sigurisë Rrugore (PNVSRR) për t'u siguruar se njollat e zeza shtesë të sigurisë rrugore që identifikohen dhe përmirësimet e duhura të sigurisë të përfshihen në punimet e mirëmbajtjes për rrugët përkatëse; dhe iii) zhvillimin dhe zbatimin e Sistemit të transparencës sociale.

Pjesa 2. Reforma institucionale

a) Kryerja e veprimtarive për të rritur kapacitetet e MTI-së, ARRSH-së dhe KNSRR-së në lidhje me kryerjen e veprimtarive nga ana e tyre për të promovuar sigurinë rrugore, që ndër të tjera do të përfshijë: i) kryerjen e kurseve të akredituara për vlerësimin e sigurisë rrugore; ii) realizimin e fushatave mediatike për sigurinë rrugore; dhe iii) zhvillimin e një baze të integruar të dhënash për të përforcuar Sistemin e Informacionit për Aksidentet.

b) Kryerja e veprimtarive për të fuqizuar kapacitetin e ARRSH-së për të: i) mbledhur dhe analizuar të dhënat rrugore; ii) realizuar studime investiguese për gjendjen e rrugëve për të mbledhur të dhëna që do të përdoren si kontribut për Sistemin e Menaxhimit të Aseteve Rrugore; dhe iii) përdorur SMARR për të përgatitur programe shumëvjeçare mirëmbajtjeje për shpenzimet dhe investimet.

Pjesa 3. Reformat në sektor

a) Dhënia e shërbimeve teknike dhe këshi-llimore për Huamarrësin për reforma të ndryshme të sektorit dhe veprimtaritë planifikuese afatmesme ose afatgjata duke përfshirë finalizimin e strategjisë së tij të sektorit të transportit.

Pjesa 4. Menaxhimi dhe auditimi i projektit

a) Fuqizimi i kapacitetit të ARRSH-së dhe të Ekipit të Menaxhimit të Projektit për të realizuar veprimtaritë e menaxhimit të projektit duke përfshirë respektimin e politikave mbrojtëse, masat për menaxhimin financiar dhe për prokurimin, si dhe financimin e kostove operative.

b) Kryerja e veprimtarive monitoruese duke përfshirë Vlerësimet e Ndikimit të Përfutjes dhe Auditimet Teknike e Auditet e DLI-ve.

PJESA 2 ZBATIMI I PROJEKTTIT

Seksioni I. Masat për zbatimin

A. Masat institucionale

1. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së:

a) do të mbikëqyrë zbatimin e Projektit;

b) do të sigurojë se ARRSH-ja përmbush përgjegjësitë e përditshme për menaxhimin dhe zbatimin e Projektit duke përfshirë këtu përgjegjësitë për prokurimin, menaxhimin financiar, monitorimin dhe vlerësimin, si dhe përgjegjësitë mjedisore dhe sociale; dhe

c) do të mbajë gjatë zbatimit të Projektit një ekip të menaxhimit të Projektit, si edhe punonjës kyçë në ARRSH, duke përfshirë këtu një specialist prokurimi, një specialist të menaxhimit financiar, të gjithë këta me funksione, përgjegjësi, kualifikime dhe përvojë të pranueshme për Bankën.

2. Në mënyrë që të zbatohet pjesa 2 e Projektit, Huamarrësi, jo më vonë se pesë muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi do të krijojë dhe do të mbajë gjatë kohës së zbatimit të Projektit një Komision Drejtues Teknik që do të ketë përgjegjësinë për të siguruar cilësinë në lidhje me aspektet teknike të sigurisë rrugore dhe që do të ketë një përbërje dhe mandat të kënaqshëm për Bankën.

B. Manuali i funksionimit të Projektit

1. Pa cenuar dispozitat e nenit V të Kushteve të Përgjithshme, Huamarrësi nëpërmjet MTI-së do të sigurojë se ARRSH-ja:

a) realizon projektin në përputhje me Manualin e Funksionimit të Projektit (MFP); dhe

b) siguron se asnjë dispozitë e MFP-së nuk do të ndryshohet, hiqet dorë, pezullohet ose shfuqizohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Bankës dhe në çdo rast mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të Manualit të Funksionimit të Projektit dhe ato të kësaj Marrëveshjeje, do të kenë përparësi dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

C. Sistemi i Transparencës Sociale

Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja krijon dhe ruan gjatë gjithë kohës së zbatimit të Projektit Sistemin e Transparencës Sociale për t'u mundësuar grupeve të interesit të sektorit të transportit të marrin pjesë dhe të japin mendimet e tyre në monitorimin e Projektit, sipas termave të referencës në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

D. Antikorrupsioni

Huamarrësi garanton realizimin e projektit në përputhje me dispozitat e udhëzimeve antikorrupsion.

E. Politikat mbrojtëse

1. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja:

a) para se të fillojë ndonjë nga punimet sipas pjesës 1 të Projektit aty ku duhet një Plan Veprimi për Shpërnguljen (PVSH) në përputhje me Politikën Kuadër të Shpërnguljes (PKSH): i) përgatit një PVSH

të pranueshëm për Bankën; dhe ii) e paraqet dhe kryen konsultime për PVSH-në e sipërpërmendur;

b) e realizon Projektin në përputhje me PVSH-në përkatëse; dhe

c) nuk ndryshon, pezullon apo shfuqizon asnjë nga dispozitat e PVSH(ve) sipas rastit, pa marrë miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

2. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja:

a) Përgatit, para fillimit të punimeve sipas pjesës 1 të Projektit, një Plan Menaxhimi Mjedisor (PMM) specifik për një vend, të pranueshëm për Bankën në përputhje me Kuadrin për Menaxhimin Mjedisor (KMM);

b) realizon projektin në përputhje me KMM-në dhe PMM-në specifike; dhe

c) nuk amendon, pezullon apo shfuqizon asnjë nga dispozitat e PMM-së specifike ose të KMM-së pa marrë miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron që ARRSH-ja: a) mban terma të kënaqshëm reference për sa i përket çdo konsulence në lidhje me Projektin në vijim të shqyrtimit nga ana e Bankës; dhe b) siguron që këta terma reference përfshijnë kriteret e politikave mbrojtëse të Bankës në fuqi në atë kohë, siç aplikohen ndaj këshillave të dhëna nëpërmjet kësaj asistence teknike.

Seksioni II. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit

A. Raportet e Projektit

1. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja monitoron dhe vlerëson progresin e Projektit dhe përgatit raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të Kushteve të Përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm nga Banka. Çdo raport Projekti mbulon periudhën e një semestri kalendarik dhe i jepet Bankës jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

2. Për qëllim të seksionit 5.08/c të Kushteve të Përgjithshme, Huamarrësi nëpërmjet MTI-së siguron përgatitjen nga ARRSH-ja të raportit për ekzekutimin e Projektit dhe të planit të lidhur me të në përputhje me atë seksion dhe se raporti i jepet Bankës jo më vonë se Data e Përfundimit.

3. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja, jo më vonë se një muaj para vlerësimit që zhvillohet në gjysmën e periudhës së projektit, që përmendet në paragrafin 4 të këtij seksioni, i paraqet Bankës për komente një raport që përmban aq hollësi sa kërkon Banka në mënyrë të arsyeshme, mbi progresin e Projektit ku jepen edhe hollësira për çështje të ndryshme që do të diskutohen gjatë atij shqyrtimi.

4. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron që ARRSH-ja, jo më vonë se pas 40 muajve pas Datës së Hyrjes në Fuqi ndërmerr së bashku me të gjitha agjencitë e përfshira në Projekt një shqyrtim të gjithanshëm të Projektit në gjysmën e periudhës së tij gjatë të cilit do të shkëmbejë mendime me Bankën dhe përgjithësisht për çështje që lidhen me progresin e Projektit, performancën e Huamarrësit dhe detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe me performancën e agjencive të sipërpërmendura zbatuese, duke pasur parasysh treguesit e performancës.

5. Në vijim të shqyrtimit të zhvilluar në gjysmën e periudhës së Projektit, Huamarrësi nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja vepron menjëherë dhe me kujdes për të ndërmarrë masa korrigjuese që çmohen të nevojshme për të trajtuar mangësitë e vërejtura gjatë zbatimit të Projektit ose për të marrë masa të tjera të tilla që duhen për të zhvilluar më tej objektivat e Projektit.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe kontrollet financiare

1. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja mban ose merr masa për mbajtjen e një sistemi të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të Kushteve të Përgjithshme.

2. Huamarrësi, nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja përgatit dhe i paraqet Bankës jo më vonë se dyzet e pesë ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik raportet financiare paraprake të pakontrolluara (RFP) për Projektin që mbulon semestrin, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën.

3. Huamarrësi nëpërmjet MTI-së siguron se Pasqyrat Financiare të ARRSH-së kontrollohen në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09/b të Kushteve të Përgjithshme. Çdo kontroll financiar i pasqyrave financiare mbulon periudhën e një viti fiskal të Huamarrësit. Pasqyrat financiare të kontrolluara për çdo periudhë të tillë duhet t'i paraqiten Bankës jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

C. Auditimet e ILD-ve

1. Në zbatimin e pjesëve 1 dhe 2 të Projektit, Huamarrësi, nëpërmjet MTI-se siguron se ARRSH-ja:

a) Jo më vonë se tre muaj para përfundimit të çdo viti ose në një datë të mëvonshme siç bihet dakord me Bankën, ARRSH-ja kryen një audit të pavarur të IDL-ve që ndër të tjera do të verifikojë shkallën në të cilën: i) Shpenzimet e pranueshme të vitit që mbulohen nga auditit janë bërë në përputhje me politikat mbrojtëse dhe me masat e prokurimit të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe sipas Manualit të Funkcionimit të Projektit; dhe ii) janë arritur Treguesit e Lidhur me Disbursimin për vitin që mbulohet nga auditit. Jo më

vonë se tre muaj pas fundit të çdo viti ose në një datë të mëvonshme siç bihet dakord me Bankën, ARRSH-ja i paraqet Bankës një Raport të plotë për ILD-të, të pranueshëm për Bankën, ku përfshihen të gjitha gjetjet dhe rezultatet e auditit për ILD-të, si edhe ndonjë konstatim nga ai auditim.

D. Auditimet teknike

1. Gjatë zbatimit të pjesës 1 të Projektit, Huamarrësi nëpërmjet MTI-së siguron se ARRSH-ja:

a) Realizon, jo më vonë se tre muaj para fundit të çdo viti ose në një datë të mëvonshme siç bihet dakord me Bankën, një audit teknik të pavarur.

b) I paraqet Bankës jo më vonë se tre muaj pas fundit të çdo viti ose në një datë të mëvonshme siç bihet dakord me Bankën një raport të plotë të auditit teknik ku përfshihen të gjitha gjetjet dhe rezultatet e auditit teknik.

c) I jep Bankës mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer mendime me Huamarrësin dhe me ARRSH-në për atë raport, duke marrë parasysh opinionet e Bankës për çështjen.

Seksioni III. Prokurimi

A. Të përgjithshme

1. Mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente që kërkohen për Projektin dhe që financohen nga fondet e Huas, duhet të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashikuara ose të përmendura në seksionin I të Udhëzimeve për Prokurimin dhe në dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve të nevojshme për Projektin dhe që financohen nga fondet e Huas duhet të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashikuara ose të përmendura në seksionet I dhe IV të udhëzimeve për konsulentët dhe në dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizime. Termat me germa kapitale, të përdorur më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metodat e rishikimit nga Banka të kontratave të veçanta, i referohen metodës korresponduese të përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve për prokurimin ose seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve për konsulentët, sipas rastit.

B. Metoda të veçanta të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente

1. Tenderi i hapur ndërkombëtar. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat, punimet dhe shërbimet jokonsulente duhet të prokurohen sipas kontratave që lidhen mbi bazën e Tenderit të Hapur Ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsulente. Përveç Tenderit të Hapur Ndërkombëtar për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve jokonsulente për ato kontrata që specifikohen në Planin e Prokurimit mund të përdoren metodat e mëposhtme: a) Blerja; dhe b) Kontraktimi i drejtpërdrejtë.

C. Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

1. Përzgjedhja e bazuar në cilësi dhe në kosto. Përveçse kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve duhet të prokurohen sipas kontratave të lidhura mbi bazën e përzgjedhjes të bazuar në cilësi dhe në kosto.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve. Përveç përzgjedhjes së bazuar në cilësi dhe kosto për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve për ato detyra që specifikohen në planin e prokurimit mund të përdoren metodat e mëposhtme: a) Përzgjedhja e bazuar në cilësi; b) Përzgjedhja sipas një buxheti fiks; c) Përzgjedhja e bazuar në koston më të ulët; d) Përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; e) Përzgjedhja nga një burim i vetëm i firmave konsulente; f) Procedurat e parashikuara në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të Udhëzimeve për Konsulentët për Përzgjedhjen e Konsulentëve Individualë; dhe g) Procedurat me një burim të vetëm për përzgjedhjen e Konsulentëve Individualë.

D. Rishikimi nga Banka i vendimeve të prokurimit

Plani i prokurimit përcakton ato kontrata që do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës. Të gjitha kontratat e tjera i nënshtrohen rishikimit të mëpasshëm të Bankës.

Seksioni IV. Tërheqja e fondeve të Huas

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat nga Huaja në përputhje me dispozitat e nenit II të Kushteve të Përgjithshme, këtë seksion dhe me udhëzimet e tjera shtesë të Bankës, siç specifikohen prej saj dhe i njoftohen Huamarrësit (duke përfshirë "Udhëzimet e Bankës Botërore për Disbursimet për Projektet", nxjerrë në maj 2006, siç rishikohen herë pas here nga Banka dhe siç zbatohen në këtë Marrëveshje në përputhje me këto udhëzime), për financimin e shpenzimeve të pranueshme, siç parashikohet në tabelën në paragrafin 2 më poshtë (udhëzimet shtesë).

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e Shpenzimeve të Pranueshme që mund të financohen nga të ardhurat nga Huaja (kategori), ndarjen e shumave të Huas për secilën kategori dhe përqindjen e

shpenzimeve që do të financohen për shpenzimet e pranueshme në secilën kategori.

Kategoria	Shuma e Huas së alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (duke përfshirë taksat)
1. Mallra, punime, shërbime të konsulentëve dhe trajnim për pjesët 1 dhe 2 të Projektit	59,310,000	deri në 50% në përputhje me dispozitat e MFP-së
2. Shërbime të konsulentëve dhe kosto operative për pjesët 3 dhe 4 të Projektit	6,425,250	deri në 84% në përputhje me dispozitat e MFP-së
3. Komisioni i administrimit	164,750	Shuma të pagueshme në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me seksionin 2.07/b të Kushteve të Përgjithshme
4. Tavan i normës së interesit ose prim i normës së interesit brenda një intervali të caktuar	0	Shumë e pagueshme në përputhje me seksionin 2.08/c të kësaj Marrëveshjeje
SHUMA TOTALE	65,900,000	

B. Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht dispozitave të pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesat e bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje.

2. Para derdhjes së paradhënies fillestare në llogarinë e caktuar (siç përkufizohen termat “paradhënie” dhe “Llogari e caktuar” në udhëzimet shtesë), Huamarrësi nëpërmjet MTI-së siguron dorëzimin nga ARRSH-ja të parashikimit për lëvizjen e fondeve të investimeve për dy semestrat e parë të vitit 1 duke mbuluar shpenzimet e pranueshme për semestrat e sipërpërmendur në vitin 1.

3. Pavarësisht udhëzimeve shtesë dhe dispozitave të paragrafit 2 më sipër, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për kategorinë 1 derisa Huamarrësi nëpërmjet MTI-së të ketë siguruar që ARRSH-ja i ka dhënë Bankës:

a) RFP-të e përmendura në seksionin II.B.2 për vitin përkatës, të cilat janë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën; dhe

b) Raportin përkatës të Auditit të ILD-së që vërteton arritjen e ILD-ve për vitin përkatës, siç parashikohen në pjesën 4 të kësaj Marrëveshjeje.

4. Në lidhje me sa më sipër, Banka mund të kufizojë tërheqjet siç janë parashtruar më poshtë, nëse përcakton, bazuar në provat që përmenden në seksionin IV.B.3 më sipër se objektivat e parashikuar në pjesën 4 nuk janë arritur apo janë arritur pjesërisht:

a) Për sa i përket ILD 1.1 dhe 1.2, nëse objektivat për ato ILD janë arritur vetëm pjesërisht, shuma e Huas që do të tërhiqet do të reduktohet në përpjesëtim me masën përkatëse të arritjes së ILD-së në përputhje me formulën e parashikuar në Manualin e Funksionimit të Projektit dhe çdo shumë e patërhequr e tërheqjes së kërkuar për vitin në fjalë do të mbetet e disponueshme për tërheqjen vijuese; ose

b) Për sa i përket ILD 1.1, 1.2, 1.3 (në lidhje me vitin 1) 2.1 dhe 2.3, nëse nuk janë arritur objektivat e ILD-ve, shuma totale e kërkesës përkatëse për tërheqje do të mbetet e disponueshme për tërheqjen vijuese; ose

c) Për sa i përket ILD 1.3 (në lidhje me vitet 2 deri 5) dhe 2.2, nëse objektivat e këtyre ILD-ve janë arritur pjesërisht ose mbeten të paarritura për vitin përkatës, shuma e Huas që duhet të tërhiqet do të reduktohet në përpjesëtim me masën e arritjes së ILD-së në përputhje me formulën e parashikuar në Manualin e Funksionimit të Projektit dhe çdo shumë e patërhequr për vitin përkatës mund të anulohet nga Banka në konsultim me Ministrinë e Financave të Huamarrësit mund të anulohet ose të rialokohet në kategorinë 2 nga Banka ose çdo përshtatje për shumën e caktuar për secilin Shpenzim të Pranueshëm brenda kategorisë 1 bëhet me miratimin e Ministrisë së Financave të Huamarrësit.

d) Pa cenuar dispozitat e paragrafëve “a” dhe “b” më sipër, çdo shumë e Huas që nuk jepet në përputhje me paragrafët në fjalë mund të anulohet ose të rialokohet në kategorinë 2 nga Banka në konsultim me Ministrinë e Financave të Huamarrësit ose për shumën e caktuar për secilin Shpenzim të

Pranueshëm brenda kategorisë 1 bëhet me miratimin e Ministrisë së Financave të Huamarrësit.

5. Banka, pas konsultimeve me Huamarrësin dhe duke e njoftuar atë, mund të përshtatë shumat dhe objektivat e parashikuar në pjesën 4 të kësaj Marrëveshjeje për ILD specifike.

6. Data e mbylljes është 31 dhjetor 2021.

PJESA 3 AFATI I AMORTIZIMIT

1. Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të Huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të Huas që paguhet për çdo datë të pagesës së principalit (pjesa e kështit). Nëse fondet e Huas janë tërhequr plotësisht brenda datës së parë të pagesës së principalit, shuma e principalit të Huas së shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagesës së principalit përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: a) Balancën e Tërhequr të Huas brenda datës së parë të pagesës së Principalit; me b) Pjesën e kështit për çdo datë të pagesës së principalit.

Data e pagesës së principalit	Pjesa e kështit (e shprehur në përqindje)
Më 15 maj dhe 15 nëntor Duke filluar nga data 15 maj 2022 deri në 15 nëntor, 2036	3.23%
Më 15 maj 2037	3.10%

2. Nëse shumat e Huas nuk janë tërhequr plotësisht brenda datës së parë të pagesës së principalit, shuma principale e Huas e shlyeshme nga Huamarrësi në çdo datë të pagesës së principalit përcaktohet si më poshtë:

a) Kur një shumë e Huas është tërhequr deri në datën e parë të pagesës së principalit, Huamarrësi shlyen balancën e tërhequr të Huas deri në këtë datë në përputhje me paragrafin 1 të kësaj pjese.

b) Çdo shumë e tërhequr pas datës së parë të pagesës së principalit do të shlyhet në çdo datë të pagesës së principalit pas datës së kësaj tërheqjeje në shumat e përcaktuara nga banka, duke shumëzuar shumën e çdo tërheqjeje të tillë me një thyesë, numëruesi i së cilës është pjesa e kështit fillestar në tabelën e paragrafit 1 të kësaj pjese për këtë datë të pagesës së principalit (pjesa fillestare e kështit) dhe emëruesi i të cilës është shuma e të gjitha pjesëve të mbetura të kështit fillestar për datat e pagesës së principalit që bien në ose pas kësaj date ku këto shuma të shlyeshme duhet të përshtaten, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të përmendur në paragrafin 4 të kësaj pjese për të cilën zbatohet konvertimi i monedhës.

c) Shumat e Huas, të tërhequra brenda dy muajve kalendarikë para çdo date të pagesës së principalit, vetëm për qëllimet e llogaritjes së shumave të principalit të pagueshme në çdo Datë të pagesës së principalit, trajtohen si të tërhequra dhe të pashlyera në datën e dytë të pagesës së principalit pas datës së tërheqjes dhe janë të shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit që fillon në datën e dytë të pagesës së principalit pas datës së tërheqjes.

d) Pavarësisht dispozitave të nënparagrafit “a” të këtij paragrafi, nëse në një kohë të caktuar Banka miraton një sistem faturimi me datë të kërkueshme sipas të cilit faturat lëshohen në ose pas datës përkatëse të pagesës së principalit, dispozitat e këtij nënparagrafi nuk vazhdojnë të zbatohen për asnjë tërheqje të kryer pas miratimit të këtij sistemi faturimi.

4. Pavarësisht dispozitave të nënparagrafëve 1 dhe 2 të kësaj pjese, në kohën e konvertimit të monedhës së të gjithë ose të një pjese të balancës së Huas së Tërhequr në një monedhë të miratuar, shuma e konvertuar në monedhën e aprovuar që është e shlyeshme në çdo datë të pagesës së principalit që bie gjatë periudhës së konvertimit, do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar këtë shumë në monedhën e saj të përcaktuar menjëherë para Konvertimit me: i) normën e këmbimit që reflekton shumat e principalit në monedhën e aprovuar e pagueshme nga Banka sipas transaksionit të sigurimit të monedhës në lidhje me konvertimin; ose ii) nëse Banka vendos në këtë mënyrë, në pajtim me udhëzimet e konvertimit, komponentin e normës së këmbimit të afishuar.



PJESA 4
TREGUESIT E LIDHUR ME DISBURSIMIN

Objektivat e ILD-ve		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Pjesa totale e shumës së Huas (në milionë EURO)	Prova që duhet t'i paraqiten Bankës
1.1 Gjatësia e rrugës ku është kryer mirëmbajtja periodike	Përqindja e rrugëve të Projektit ku është kryer mirëmbajtja rutinë	28% nga një nivel bazë prej 0%	22% përveç objektivit të arritur në vitin 1	22% përveç objektivit të arritur në vitin 1 dhe 2	22% përveç objektivit të arritur në vitet 1-3	6% përveç objektivit të arritur në vitet 1-4		Raportet e auditeve të ILD-ve për secilin vit përkatës
	Pjesa e shumës së Huas (e shprehur në milionë USD)	7.48	5.87	5.87	5.87	1.60	26.69	
1.2 Objektivat e mirëmbajtjes rutinë të arritur	Përqindja e shumës së mbledhur të kontratës së KHMRRBP-ve të paguara në secilin vit përkatës	Mesatarisht të paktën 80%	Mesatarisht të paktën 80%	Mesatarisht të paktën 80%	Mesatarisht të paktën 80%	Mesatarisht të paktën 80%		
	Pjesa e shumës së Huas (e shprehur në milionë euro)	5.33	3.56	3.56	3.56	1.78	17.79	Raportet e auditeve të ILD-ve për secilin vit përkatës
1.3 Sistemi i Transparencës Sociale është zhvilluar dhe është në punë	STS është zhvilluar dhe është në punë (siç parashikohet nga Manuali i Funksionimit të Projektit)	STS është zhvilluar	STS funksional për gjithë vitin	STS funksional për gjithë	STS funksional për gjithë	STS funksional për gjithë		
	Pjesa e shumës së Huas (e shprehur në milionë USD)	0.375	0.74	0.74	0.74	0.375	2.97	
2.1 Përfundimi i studimeve investiguese periodike PNVRR	Janë kryer studime investiguese periodike PNVRR që tregojnë Vlerësim me Yje	Është kryer studimi investigues PNVRR dhe është përcaktuar niveli bazë i Vlerësimit me Yje	E pazbatueshme	Është kryer studimi investigues PNVRR dhe është arritur vlerësim me yje më i lartë se nivelit bazë i vlerësimit me yje	E pazbatueshme	Është kryer studimi investigues PNVRR dhe është arritur vlerësim me yje më i lartë se niveli bazë i vlerësimit me yje		



Objektivat e ILD-ve		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Pjesa totale e shumës së Huas (në milionë EURO)	Prova që duhet t'i paraqiten Bankës
	Pjesa e shumës së Huas (e shprehur në milionë USD)	0.99	-	0.99	-	0.99	2.97	Raportet e auditeve të ILD-ve për secilin vit përkatës
2.2 SMARR krijuar dhe është në punë	Studimi vjetor për gjendjen është kryer sipas termave të referencës të specifikuar në Manualin e Funksionimit të Projektit dhe në programin shumëvjeçar të mirëmbajtjes të përgatitur në përputhje përkatësisht me pjesën 2/b(ii) dhe (iii) të Projektit	Po	Po	Po	Po	Po		
	Pjesa e shumës së Huas (e shprehur në milionë euro)	1.186	1.186	1.186	1.186	1.186	5.93	
2.3 Kontrata e Standardit të Shërbimit është nënshkruar	Kontrata e Standardit të Shërbimit është nënshkruar	E pazbatueshme	E pazbatueshme	E nënshkruar	E pazbatueshme	E pazbatueshme		
	Pjesa e shumës së Huas (e shprehur në milionë USD)	-	-	2.96	-	-	2.96	
Pjesa e shumave të Huas për secilin ild në vit		15.36	11.36	15.31	11.36	5.93	TOTALI: 59.31	



SHTOJCË

Seksioni I. Përkufizime

1. “Sistemi i informacionit për aksidentet” është baza e të dhënave për aksidentet e krijuara në Drejtorinë e Qarkullimit Rrugor të Ministrisë së Brendshme të Huamarrësit.

2. “Udhëzime shtesë” janë udhëzimet shtesë të përmendura në seksionin IV.A.1 të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe këto udhëzime shtesë mund të rishikohen herë pas here nga Banka dhe t’i paraqiten Huamarrësit.

3. “Autoriteti Rrugor Shqiptar” ose “ARRSH” është agjencia e Huamarrësit përgjegjëse për të ndërtuar, përmirësuar, rehabilituar dhe mirëmbajtur rrjetin rrugor kombëtar (duke përfshirë rrugët parësore dhe rrjetin e rrugëve parësore-dytësore) dhe planifikimin përkatës, buxhetimin, si dhe programimin, e krijuar sipas ligjit të Huamarrësit nr. 10164 të tetorit 2009 ose pasardhësi i saj i ligjshëm.

4. “Udhëzimet antikorrupsion” janë “Udhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s”, të datës 15 tetor 2006, të rishikuar në janar të vitit 2011.

5. “Politikat Mbrojtëse të Bankës” do të thotë politikat dhe procedurat për funksionimin Bankës, të parashikuara në manualin operacional dhe të identifikuara, si OP/BP 4.01, 4.04, 4.09, 4.10, 4.11, 4.12, 4.36, 4.37, 7.50 dhe 7.60, të manualit të sipërpërmendur të publikuar në www.WorldBank.org/opmanual.

6. “Vlerësimi i ndikimit të përfituesit” është një analizë sistematike që realizohet për të marrë dhe për të dokumentuar ndikimet e Projektit të përdoruesit të rrugës, me synimin për të përmirësuar praktikën e Huamarrësit për mirëmbajtjen e rrugëve.

7. “Kategori” do të thotë një kategori e parashikuar në tabelën në seksionin IV, të pjesës 2, të kësaj Marrëveshjeje.

8. “Udhëzimet për Konsulentët” do të thotë “Udhëzimet: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve në kuadrin e huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore” i janarit të vitit 2011 (i rishikuar në korrik 2014).

9. “Tregues i lidhur me disbursimin” ose “ILD” është një tregues i parashikuar në pjesën 4, të kësaj Marrëveshjeje, arritja e të cilit është një kusht për disbursimin e të ardhurave të Huas sipas seksionit IV.B.3 të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

10. “Persona të zhvendosur” janë personat të cilët për shkak të zbatimit të Projektit do të kenë pasoja të drejtpërdrejta ekonomike dhe sociale që rezultojnë në: a) marrjen e pavullnetshme të tokës që do të ketë si pasojë: i) zhvendosjen ose humbjen e strehimit; ii) humbjen e aseteve ose të aksesit në asete; dhe iii) humbjen e burimeve të të ardhurave ose të mjeteve të sigurimit të jetesës, pavarësisht nëse personat e prekur duhet të shpërngulen në një vend tjetër apo jo; ose b) kufizimin e pavullnetshëm të aksesit ndaj parqeve të projektuara ligjërisht dhe ndaj zonave të mbrojtura që rezultojnë në ndikime negative në jetesën e atyre personave.

11. “Auditimi i ILD-së” është çdo kontroll verifikues i pavarur i treguesve të lidhur me performancën që kryhet çdo vit, referuar seksionit II.B.1 të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

12. “Raport i Auditimit të ILD-së” është çdo raport i përgatitur dhe i paraqitur pranë Bankës në përputhje me seksionin II.C.2/b të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

13. “Kuari i Menaxhimit Mjedisor” ose “KMM” është kuadri i përgatitur nga Huamarrësi në nëntor 2014, dhe i bërë publik më 1 dhjetor 2014, i cili parashikon modalitetet për verifikimet dhe procedurat mjedisore për përgatitjen dhe zbatimin e planeve të menaxhimit mjedisor sipas pjesës 1 të Projektit dhe këto kushte përfshijnë të gjitha pjesët dhe shtojcat e KMM-së.

14. “Plani i Menaxhimit Mjedisor” ose “PMM” është plani i Huamarrësit për pjesën I të Projektit, që ka formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka për zbutjen e ndikimeve të mundshme mjedisore që



jep hollësi të masave për menaxhimin e rreziqeve të mundshme mjedisore dhe që zbusin, reduktojnë dhe/ose kompensojnë ndikimet negative mjedisore, së bashku me masat e duhura institucionale, monitoruese dhe raportuese që mund të sigurojnë zbatimin e duhur dhe reagime të rregullta mbi përputhshmërinë me, termat e tij, pasi ky plan mund të ndryshohet dhe/ose plotësohet herë pas herë duke pasur miratimin paraprak me shkrim nga Banka.

15. “Kushte të Përgjithshme” janë “Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim për Huat”, të datës 12 mars 2012 me modifikimet e paraqitura në seksionin II të kësaj shtojce.

16. “Kontrata hibride të mirëmbajtjes së rrugëve të bazuara në performancë” ose “KHMRRBP” janë katër kontratat shumëvjeçare sipas pjesës 1 të Projektit që duhet të lidhen nga ARRSH-ja me katër kontraktues të sektorit privat, secila prej tyre për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, të cilat i detyrojnë kontraktuesit e sektorit privat të ndërmarrin: i) mirëmbajtje periodike; ii) mirëmbajtje rutinë; dhe iii) punime emergjence në lidhje me një pjesë të identifikuar të rrugëve të Projektit ku pagesa për ato që realizohen lidhet me performancën.

17. “RFP” është raport financiar paraprak i pakontrolluar

18. “KNSRR” është Komiteti Ndërmarrës i Sigurisë Rrugore i kryesuar nga Kryeministri i Huamarrësit.

19. “Programi Ndërkombëtar për Vlerësimin e Rrugëve” ose “PNVRR” është një organizatë bamirësie/asistence e regjistruar në Mbretërinë e Bashkuar me numrin 1140357, e cila i dedikohet sigurisë rrugore, ose pasardhësja e saj e ligjshme.

20. “Studimi investigues i Programit Ndërkombëtar të Vlerësimit të Rrugëve” ose “Studimi investigues PNVRR” është një studim i hollësishëm për rrugët dhe mbledhja e të dhënave e kryer nga PNVRR në Rrugët e Projektit ku rezultatet paraqiten me vlerësimin me yje.

21. “MTT” është Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Huamarrësit.

22. “Kostot operative” janë shpenzime të arsyeshme që rriten gradualisht që dalin gjatë projektit dhe që konsistojnë në pagat e Ekipit të Menaxhimit të Projektit (duke përjashtuar pagat e nëpunësve civilë të Huamarrësit) dhe në shpenzime që lidhen me realizimin e veprimtarive të Projektit, kostot për mbajtjen e zyrës, dietat për stafin, mobilie për zyrë, materiale dhe furnizime, kostot e komunikimit, reklamave dhe kostot e karburantit për vizitat në terren.

23. “Rrugët parësore” janë autostradat dhe korridoret rrugore kryesore të Huamarrësit.

24. “Rrugët parësore-dytësore” janë rrugët e Huamarrësit, përveç rrugëve parësore, të cilat lidhin qytetet kryesore dhe vendet turistike siç dhe ato që të çojnë drejt pikave të kalimit të kufirit me vendet fqinje, brenda territorit të Huamarrësit.

25. “Udhëzimet për prokurimin” janë “Udhëzimet: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe i shërbimeve jokonsulente në kuadrin e huave të IBRD-së dhe kredive e granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore” i janarit 2011 (i rishikuar në korrik 2014).

26. “Plan prokurimi” është plani i prokurimit të Huamarrësit për Projektin, i datës 29 janar 2015 dhe i përmendur në paragrafin 1.18 të Udhëzimeve për Prokurimin dhe paragrafin 1.25 të Udhëzimeve për Konsulentët, i cili do të përditësohet herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafëve të sipërpërmendur.

27. “Ekipi i menaxhimit të projektit” janë grupi i përzgjedhur i punonjësve të ARRSH-së dhe i konsulentëve individualë që janë përgjegjës për të dhënë mbështetje për menaxhimin e projektit dhe që përmendet në seksionin 1.A.1/c të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

28. “Manuali i Funksionimit të Projektit” ose “MFP” është manuali i Huamarrësit me gjithë shtojcat dhe pjesët që është i pranueshëm për Bankën dhe që është miratuar nga Huamarrësi, i cili



paraqet politikat dhe procedurat që aplikohen për zbatimin e projektit të cilat përfshijnë, ndër të tjera: a) rolet dhe përgjegjësitë e ARRSH-së; b) kërkesat për punonjës për Projektin; c) afatet në të cilat vlerësohet se do të zbatohet projekti; d) procedurat për të pasur akses, për të disbursuar dhe raportuar për fondet e projektit; e) treguesit e ILD-së që duhet të përdoren për monitorimin dhe vlerësimin e pjesëve 1 dhe 2 të Projektit; f) procedurat për monitorimin, mbikëqyrjen dhe vlerësimin e Projektit duke përfshirë formën dhe përmbajtjen e raporteve të projektit; dhe g) procedurat e prokurimit dhe ato të menaxhimit financiar që mund të ndryshohen herë pas here duke pasur miratimin paraprak me shkrim nga Banka, kusht i cili përfshin çdo pjesë, tabelë dhe shtojcë të Manualit të Funksionimit të Projektit.

29. “Rrugët e Projektit” janë rrugët parësore dhe rrugët parësore-dytësore.

30. “Sistemi për Menaxhimin e Aseteve Rrugore” ose “SMARR” është një platformë e teknologjisë së informacionit që përdoret për të mbledhur dhe për të administruar studime për gjendjen e rrugëve, për të planifikuar dhe alokuar buxhetin për shpenzime të mirëmbajtjes së rrugëve, si dhe për investime në nivel seksioni, korridori ose rrjeti.

31. “Plani i veprimit për shpërnguljen” ose “PVSH” është plani i veprimit specifik për një vend të caktuar, ku përfshihet ndonjë plan shpërnguljeje i shkurtuar i miratuar nga Huamarrësi dhe ARRSH-ja në përputhje me PKS-ën dhe me këtë Marrëveshje që është i pranueshëm për Bankën dhe që ndër të tjera përmban një program veprimesh, masash dhe politikash për kompensimin dhe shpërnguljen e personave të zhvendosur, duke përfshirë masat për kompensim dhe shpërngulje, buxhetin dhe kostot e vlerësuara dhe burime të financimit, së bashku me masa të përshtatshme institucionale, monitoruese dhe raportuese, të cilat mund të sigurojnë zbatimin e duhur dhe reagime të rregullta mbi përputhshmërinë me kushtet e tij për secilin vend.

32. “Politika kuadër për shpërnguljen” ose “PKSH” është politika kuadër për shpërnguljen e Huamarrësit, e nëntorit 2014 dhe e bërë publike në nivel lokal më 1 dhjetor 2014, ku parashikohen modalitetet për shpërnguljen dhe kompensimin e personave të zhvendosur sipas pjesës 1 të Projektit.

33. “Kontratë e standardit të shërbimit” është marrëveshja, aktualisht draft, e cila duhet të finalizohet dhe të firmoset ndërmjet MTI-së dhe ARRSH-së, në përputhje me ligjin e Huamarrësit nr. 10164 të tetorit 2009, që parashikon, ndër të tjera, standardet e mirëmbajtjes së rrjetit kombëtar rrugor bazuar në fonde të alokuara çdo vit në bazë të periudhës afatmesme.

34. “Sistemi i transparencës sociale” ose “STS” është një sistem për të marrë reagime dhe për të zgjidhur ankesat që lejon përdoruesit e rrugës dhe publikun të japin reagimet e tyre për Projektin dhe siguron një ndërfaqe për ndarjen e informacionit mbi mirëmbajtjen e rrugëve.

35. “Vlerësim me yje” është matja e IRAP-it për sigurinë rrugore në të cilën një vlerësim me pesë yje tregon rrugët më të sigurta, ndërsa një vlerësim me një yll tregon rrugët më pak të sigurta.

36. “Auditim teknik” është shqyrtimi teknik i pavarur i planifikimit, i projektimit dhe i punimeve të ndërtimit dhe të mirëmbajtjes parashikuar në pjesën 1 të Projektit.

37. “Komisioni teknik drejtues” është komisioni i Huamarrësit i përmendur në seksionin I.A.2 të pjesës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

38. “Trajnim” do të thotë shpenzime (të ndryshme nga ato që lidhen me Shërbime të Konsulentëve), që dalin në lidhje me trajnime dhe seminare që lidhen me Projektin dhe që realizohen në përputhje me planet e trajnimeve, të përgatitura nga ARRSH-ja të miratuara nga Banka, duke përfshirë këtu vizita studimore, kurse trajnimi, seminare dhe veprimtari të tjera trajnuese, duke përfshirë kostot e materialeve të trajnimit, të marrjes me qira të mjediseve dhe pajisjeve, udhëtimit lokal, dietat e pjesëmarrësve në trajnim dhe tarifat e trajnerëve dhe shërbimet e interpretimit dhe të përkthimit.

39. “Viti” ose “vitet” do të thotë çdo ose të gjitha viti 1, viti 2, viti 3, viti 4 ose viti 5, siç mund ta



kërkojë konteksti.

40. “Viti 1” është periudha që fillon në datën e hyrjes në fuqi dhe mbaron më 31 dhjetor 2016.
41. “Viti 2” është periudha 12-mujore që fillon më 1 janar 2017 dhe mbaron më 31 dhjetor, 2017.
42. “Viti 3” është periudha 12-mujore që fillon më 1 janar 2018 dhe mbaron më 31 dhjetor 2018.
43. “Viti 4” është periudha 12-mujore që fillon më 1 janar 2019 dhe mbaron më 31 dhjetor 2019.
44. “Viti 5” është periudha 12-mujore që fillon më 1 janar 2020 dhe mbaron më 31 dhjetor 2020.

Seksioni II. Ndryshime të kushteve të përgjithshme

Kushtet e Përgjithshme ndryshohen si më poshtë:

Në tabelën e lëndës, referimet ndaj seksioneve, emrave të seksioneve dhe numrave të seksioneve ndryshohen për të reflektuar modifikimet e paraqitura në paragrafin e mëposhtëm.

2. Seksioni 3.01 (Komisioni i administrimit) ndryshohet si më poshtë:

“Seksioni 3.01. Komisioni i administrimit; Komisioni i Angazhimit

Huamarrësi i paguan Bankës një komision administrimi për shumën e Huas me normën e përcaktuar në Marrëveshjen e Huas (Komisioni i Administrimit).

Huamarrësi i paguan Bankës një komision angazhimi për gjendjen e patërhequr të Huas me normën që përcaktohet në Marrëveshjen e Huas (Komisioni i Angazhimit). Komisioni i angazhimit do të grumbullohet nga një datë gjashtëdhjetë ditë pas datës së Marrëveshjes së Huas deri në datat përkatëse në të cilat shumat tërhiqen nga Huamarrësi prej Llogarisë së Huas ose anulohen. Komisioni i Angazhimit paguhet dy herë në vit në secilën Datë Pagese.”.

3. Te shtojca, përkufizimet, të gjitha referimet përkatëse ndaj numrave dhe paragrafëve të seksioneve ndryshohen sipas nevojës për të reflektuar modifikimet e paraqitura në paragrafin 2 më sipër.

4. Shtojca ndryshohet duke shtuar një paragraf të ri 19 me përkufizimin e mëposhtëm të “Komisionit të Angazhimit”, dhe duke rregulluar numrat e paragrafëve vijues:

“19. “Komisioni i angazhimit” do të thotë komisioni i angazhimit i përcaktuar në Marrëveshjen e Huas për qëllim të seksionit 3.01/b.”.